

Hapet thirrja për aplikime për bursa në kuadër të programit Erasmus+ KA107 në Universitetin e Huelvas në Spanjë, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për mësimdhënie dhe trajnim për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Huelvas në Spanjë, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për mësimdhënie dhe trajnim.

<http://uhu.es/english/>

Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie/trajnim (5 ditë + 2 ditët e udhëtimit);

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin ditor për stafin (160 EUR në ditë);
-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës:

- CV (në gjuhën angleze/spanjolle) + Lista e publikimeve (për stafin akademik);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/spanjolle);
- Vërtetim punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;

-Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet në kuadër të programit Erasmus+ dhe nëse po, ku;

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

Plani i Mobilitetit për mësimdhënie / trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies / trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatori Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: **19 Prill 2022**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratën e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!